



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	05.02.2026
Referencë	11-344/1
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-janar

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit janar Drejtoria e Inspektoratit ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektorët e tregut- Janë inspektuar biznese të ndryshme afariste, objektivi i inspektimit ka qenë regjistrimi i bizneseve, pranimi teknik i lokaleve në të cilat realizohet biznes, urdhëresat për pranim teknik, si dhe realizimi i pranimeve teknike pas plotësimit të kriterëve.

Në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” janë inspektuar veprimtarit ilegale, dha auto-taxi ilegal ku nuk është hasur ndonjë duke ushtruar veprimtari ilegale

Gjatë muajit janar është bërë inspektimi i tregjeve si: tregut të gjelbër, kafshëve dhe mobileve.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Është inspektuar një Qendër Grumbulluese e Gomave të automjeteve jashtë përdorimit në fshatin Torin. Pronari nuk posedonte dokumentacion, respektivisht Leje Mjedisore për ushtrimin e këtij aktiviteti, dhe ju është dhënë urdhëresë që të filloj procedurat për t’u pajisur me leje nga MMPHI. Për këtë inspektim është njoftuar edhe Inspektorati, sektori i mjedisit në nivel qendror.

Sipas ankesave të pranuar, dy qytetarë janë urdhëruar për largimin e mbeturinave nga hapësira publike, në rrugën për në fshatin Rubovc dhe në fshatin Shalë. Pas Ri-kontrollave në teren u konstatua se urdhëresat janë zbatuar.

Gjatë kontrollave në fshatin Sllovi janë parë kablllo të internetit të hedhura nëpër rrugë, trotuare hapësira publike. Këto kablllo ishin hedhur nga Keds gjatë largimit të shtyllave elektrike.

Janë njoftuar përgjegjësit e Keds-it për veprimet e kundërligjshme që kanë bërë punëtorët dhe janë ftuar në inspektorat përmes Policisë që të paraqiten në inspektorat, ku edhe ju është dhënë urdhëresë për largimin e të gjitha kablllove nga vendet ku janë hedhur. Pas Ri-Kontrollave në teren urdhëresat ishin zbatuar.

Janë kontrolluar deponit ilegale të mbeturinave në fshatrat Torin, Gllanicë, Topliqan i Vjetër, Sllovi, për të marrë masa ligjore ndaj atyre që takohen apo gjeten dëshmi për ndotje të mjedisit.

Inspektorët e trafikut- Gjatë muajit janar kemi bërë inspektimin e firmave të autobusëve, auto-taksive, radio taksive, ku firmat e autobusëve i kemi kontrolluar për rend të udhëtimit dhe janë urdhëruar që të respektohet rendi i udhëtimit ashtu si është lëshuar nga organi kompetent,

Kemi mbajtur edhe kujdestari gjatë këtij muaji në Aeroportin Adem Jashari ku është bërë inspektimi i radio-taksive që marrin pasagjer pa porosi dhe auto-taksit ilegal, po ashtu janë inspektuar disa kompani të radio-taksit si Roberti, Shoferi Im, Teslla, Victoria, Onlain Taksi të cilët kishin licenc dhe merrnin udhëtar vetëm me porosi.

Inspektori i ndërtimit- ka realizuar inspektime të vazhdueshme në teren përgjatë zonave urbanistike. Janë inspektuar objekte të cilat posedojnë leje ndërtimi dhe është konstatuar gjendja e

tyre me procesverbal si dhe janë realizu vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjegjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit janar janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste si dhe janë bërë pesë pranime teknike te lokaleve afariste.

Ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspekte	Inspekte me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoba mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspekte për leje Mjedisore Komunale	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	103	12	4						47	15				75.00€	6	12	5			2
Ambienti	14	3							3	6									2	
Ndërtimi	35	8			16					9			1				1			
Trafiku	38	7						15	5							8			3	
Gjithsej	190	30	4		16			15	55	30			1	75.00€	6	20	6		5	2

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.